

INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET

4

RUBRIKA I

PLANI I INTEGRITETIT NË KOMISARIATIN NR. 1 TIRANË

- Qasje gjithëpërfshirëse në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e një plani integriteti.
- Vlerësim konkret i risqeve nga punonjësit e policisë.
- Plani i Integritetit në nivel institucioni (komisariati) i bën punonjësit e policisë objekt dhe subjekt të ndryshimit në organizatë.
- Sfida në vazhdim: integrimi i Planit të Integritetit në nivel komisariati në sistemin piramidal të menaxhimit policor.

RUBRIKA II

DILEMAT E ETIKËS DHE INTEGRITETIT NË POLICI: GJETJE DHE REKOMANDIME NGA STUDIMI.

RUBRIKA III

TAKIMET LLOGARIDHËNËSE:

Pogradec

- Kryetari i Bashkisë Ilir Xhakolli: Të vijohet me takime llogaridhënëse në çdo njësi administrative.
- Bashkia do të investojë për kamera sigurie në pika të ndryshme të qytetit për t'u menaxhuar nga policia.
- Shefi i Komisarariatit Pogradec Nikollaq Palla bëri thirrje për funksionalizimin e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike si dhe përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile. Të shihet ndryshim nga njëri takim llogaridhënës tek tjetri.
- Prokurori Sotir Kllapi: Nevojitet nxitja e mekanizmit të referimit si në bashki, por edhe në institucione të tjera si shkolla, etj.

Lezhë

- Kryetari i Bashkisë Pjerin Ndreu flet për natyrën sociale dhe ekonomike të përfshirjes në kriminalitet dhe theksoi luftën kundër “të fortëve”.
- Prokurori, Milan Laskaj: Takimet ndërinstitucionale duhet të jenë më të shpeshta duke gjetur zgjidhjen e problemeve.
- Drejtori i Policisë Vendore Lezhë, Ferdinand Mara: Siguria publike përgjegjësi kryesore jo vetëm e policisë, por e të gjithë aktorëve vendorë.





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 4
Integritet
Llogaridhënie
Partneritet
Tetor 2019

Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Redion Qirjazi, Kontribues

Armela Xhaho, Kontribuese

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Elsa Toska, Eksperte Ligjore e Etikës dhe Integritetit

Erald Bezhani, Ekspert i Menaxhimit të Riskut Institucional

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241

Shënim:

Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.

NË VEND TË HYRJES

QASJA GJITHËPËRFSHIRËSE
PËR HARTIMIN E NJË PLANI
INTEGRITETI 3

DILEMAT E ETIKËS DHE
INTEGRITETIT NË POLICINË E
SHTETIT 7

NË FOKUS 11

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE
LLOGARIDHËNËSE PËR
PARANDALIMIN E KRIMIT

Lezhë: Nevojitet analizë
periodike të shkaqeve të
kriminalitetit ndërmjet
aktorëve vendorë për masa
efikase për parandalimin dhe
uljen e nivelit të kriminalitetit 11


Bashkia Pogradec: Drejt
zhvillimit periodik të
takimeve llogaridhënese të
trekëndëshit polici-bashki-
prokurori 13

QASJA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR HARTIMIN E NJË PLANI INTEGRITETI

Metodologjia e zbatuar për vlerësimin e riskut të integritetit në komisariat nr.1 në Tiranë është mbështetur në standardet¹ dhe metodologjitë ndërkombëtare në këtë fushë. Menaxhimi i riskut të integritetit në nivel komisariati synon t'i ofrojë institucionit mjetet për të identifikuar, parandaluar dhe menaxhuar risqet e mundshme të lidhura me veprimtaritë e tij. **Plani i Integritetit është një mjet strategjik dhe operacional që mbështetet në rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit. Ai përfshin një tërësi masash për fushat e funksionit të komisariatit, të cilat krijojnë një dinamikë që ndihmon në menaxhimin me efikasitet dhe kontribuojnë që komisariati të jetë i fokusuar ndaj risqeve që cenojnë institucionin në mënyrë të vazhdueshme.**

Ky proces mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse institucionale, pasi komisariati nëpërmjet një procesi vetëvlerësimi, i cili përfshin të gjithë punonjësit e komisariatit, synon të adresojë risqet e shkeljes së integritetit për veprimtaritë që zbaton. Për këtë qëllim, shefi i komisariatit ngre një grup pune me punonjës të komisariatit për kryerjen e vlerësimit të riskut të integritetit në institucion. Punonjësit e komisariatit, sipas strukturave të brendshme, angazhohen të mbështesin grupin e punës në zbatimin e fazave të procesit nga identifikimi i risqeve deri tek adresimi i

tyre. Për këtë qëllim, përgatitet edhe një pyetësor vetëvlerësimi që mbulon fushat e funksionit të komisariatit dhe plotësohet nga të gjithë punonjësit. Këto rezultate të procesit të vetëvlerësimit i raportohen punonjësve të institucionit, për të siguruar transparencë si dhe për të përmirësuar procesin nëse është e nevojshme. Finalizimi i procesit është hartimi i një Plani Integriteti, i cili pasi konsultohet me punonjësit e komisariatit, strukturat eprore të komisariatit (Drejtoria Vendore e Policisë dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit) dhe aktorët e tjerë të interesuar, miratohet nga shefi i komisariatit.



1 Standardet ndërkombëtare përfshijnë kryesisht standardet ISO EN 31000:2009 dhe 31000:2018 për menaxhimin e riskut.

Monitorimi periodik (çdo 1 vit) është një tjetër qasje e vlerësimit të menaxhimit të riskut në komisariat. Ai përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve për zbatimin e masave të miratuara për adresimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Nëpërmjet kësaj qasjeje metodologjike punonjësit e komisariatit janë subjekt i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit për të gjitha veprimtaritë që kanë përgjegjësi si dhe janë objekt i monitorimit të zbatimit të masave të miratuara për adresimin e risqeve. Zbatimi i Planit të Integritetit ndihmon në ndërtimin e një kulture institucionale që krijon rezistencë ndaj praktikave korruptive. Gjithashtu ai rrit ndërgjegjësimin e punonjësve të të gjitha niveleve të drejtimit në komisariat për një kulturë mospranuese dhe parandaluese ndaj korrupsionit.

Në numrat e mëparshëm të këtij buletini janë analizuar në tërësi elementët, faza përgatitore identifikimi dhe vlerësimi i riskut të integritetit dhe trajnimet për zbatimin e metodologjisë që janë zhvilluar me punonjësit e komisariatit me qëllim hartimin e Planit të Integritetit (PI) për komisariatit Nr. 1 në Tiranë. Në këtë numër do të paraqesim komponentët e fazës së katërt që lidhet me përgatitjen e masave për trajtimin e risqeve të integritetit të institucionit dhe fazës së pestë të monitorimit të zbatimit të PI. Gjithashtu do të përfshihet edhe faza e pestë që ka të bëjë me monitorimin e Planit të Integritetit.

FAZA IV: PËRGATITJA E MASAVE PËR TRAJTIMIN E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Grupi Punës për Integritetin (GPI) në komisariatit nr.1, mbështetur në vlerësimin e risqeve të integritetit të kryer në fazën e mëparshme, përgatit një plan masash për trajtimin e tyre. Renditja e risqeve sipas prioriteteve shërben si bazë për përcaktimin e masave² dhe aktiviteteve të kontrollit. Hartimi i masave bëhet në mënyrë që burimet e komisariatit (financiare, njerëzore, infrastrukturore etj.) të akordohen sipas nevojave të mëdha. Masat propozohen në varësi të intensitetit të riskut (me prioritet të lartë; të moderuar ose të ulët). Risqet prioritare kërkojnë trajtim imediat me masa prioritare. Për risqet e kategorizuara si të ulëta, mund të caktohet monitorimi i vazhdueshëm ose periodik i efikasitetit të masave ekzistuese, ose masa të tjera shtesë, sipas rastit. Në mënyrë që këto masa të jenë efikase, është e nevojshme të përcaktohet për secilën masë, personi përgjegjës, si dhe afatet për zbatimin e saj.

Trajtimi i risqeve bëhet edhe përmes aktiviteteve të kontrollit që mund të jenë rregulla, procedura dhe veprime të cilat kanë për qëllim reduktimin e risqeve të integritetit për arritjen e objektivave. Aktivitetet e kontrollit të risqeve përfshijnë kontrolle parandaluese, korrigjuese,

2 Masat për trajtimin e risqeve përfshijnë: Masa për kufizimin ose uljen e riskut- planifikimi i kontrolleve që japin garanci të arsyeshme se risku kufizohet në parametra të pranueshëm në varësi të rëndësisë dhe kostove të kontrolleve. Risqet për të cilat adresohen masa të tilla kontrolli janë objekt monitorimi periodik; Transferimi i riskut- kryetari i bashkisë vlerëson se risku i lartë mund të transferohet në një institucion tjetër (me marrëveshje të përbashkët midis dy palëve); Tolerimi i riskut- kjo është masë që merret për risqet që kanë ndikim të kufizuar në arritjen e objektivave të bashkisë ose kur kostot e masave që parashikohen të merren janë në përpjesëtim të zhdrejtë me përfitimet e mundshme. Risqet, për të cilat adresohet kjo masë duhet të jenë në monitorim të vazhdueshëm. Mundësia që këto risqe të kalojnë në risqet prioritare është e lartë pasi ekziston mundësia që në ndikimin e faktorëve të ndryshëm (të brendshëm ose të jashtëm) të rritet mundësia e ndodhjes së ngjarjeve të padëshiruara dhe pasojave të tyre; Përfundimi i riskut- ka të bëjë me anashkalimin e disa risqeve duke hequr dorë përfundimisht nga objektivat që shoqërojnë këto risqe.

drejtuese ose dalluese.³

Risqet e identifikuar sipas prioritetit dhe të shoqëruara me masat përkatëse janë pjesë e Planit të Veprimit të Menaxhimit të Riskut të Integritetit. Qëllimi i Planit të Veprimit është dokumentimi i mënyrës sesi do të zbatohen masat e caktuara dhe përfshin: përshkrim të risqeve të identifikuar, objektiva të planit të veprimit, aktivitetet e propozuara, personat përgjegjës si dhe afati i zbatimit të tyre.

GPI në këtë fazë harton edhe një raport mbi gjendjen e integritetit të institucionit. Qëllimi i raportit është për të prezantuar gjendjen e integritetit të komisariatit, aktivitetet e ndërmarra nga grupi i punës si dhe masat e propozuara për përmirësimin e integritetit.

Në përfundim, grupi i punës në komisariat konsolidon dokumentacionin për zhvillimin e planit të integritetit, dhe harton një PI për komisariat. Plani i Integritetit konsultohet me punonjësit e komisariatit, strukturat e prore të komisariatit: Drejtoria Vendore e Policisë dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe aktorë të tjerë të interesuar. Plani final i Integritetit i dorëzohet për miratim shefit të komisariatit.

FAZA V: MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në formë të planifikuar, periodikisht dhe do të përditësohet në përputhje me zhvillimet apo ndryshimet ligjore dhe nënligjore, institucionale, procedurale dhe të personelit që prekin funksionet dhe veprimtarinë e komisariatit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit si një etapë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit në komisariat, siguron që:

- ▣ aktivitetet e kontrollit dhe masat e trajtimit të risqeve të integritetit të jenë efektive në hartim dhe funksionim;
- ▣ procedurat të jenë të qarta;
- ▣ dhe se plani i integritetit të përcillet në institucion.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të organizatës apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve si edhe të nxirren mësim për planifikim më të mirë në të ardhmen. Raporti i monitorimit i dorëzohet shefit të komisariatit, Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3 Aktivitetet e kontrollit përfshijnë: Aktivitete kontrolli parandaluese: të cilat synojnë uljen e mundësisë së një rezultati të padëshiruara si p.sh. ndarja e detyrave mes stafit të një sektori ku çdo punonjës nuk vepron për një vendimmarrje të caktuar pa miratimin e punonjësi tjetër etj.; Aktivitete kontrolli korrigjuese: të cilat synojnë korrigjimin e rezultateve të padëshiruara dhe parashikojnë mënyrat për rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si p.sh. kushti i sigurimit të kontratave publike i cili mundëson pagimin e dëmit financiar në rast të ndodhjes së një risku; Aktivitete drejtuese të konceptuara për arritjen e një rezultati të caktuar (si p.sh. masat e sigurisë, apo kërkesat për ruajtjen e shëndetit dhe të jetës); ose që stafi të jetë trajnuar me aftësitë e kërkuara që të lejohet të punojë i pa mbikëqyrur; Aktivitete kontrolli zbuluese të konceptuara për të identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (p.sh. kontrole të rezervave, aktiveve apo procedurave të rakordimit).

Përgjegjësitë për monitorimin e rregullt të Planit të Integritetit i janë caktuar një punonjësi nga shefi i komisariatit.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga shefi i komisariatit, i cili është përgjegjës për progresin e implementimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda periudhës gjashtë mujore. Raportimi i

dorëzohet shefit të komisariatit, Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Raportimi i lejon Shefit të Komisarariatit të ndërmarrë në kohën e duhur masa përmirësuese në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

ÇFARË TRAJTON KY NUMËR I BULETINIT?

Ky numër i Buletinit “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet” ka në fokus analizën e avantazheve të qasjes gjithëpërfshirëse në zhvillimin e Planit të Integritetit (PI) për Komisariatin Nr. 1 Tiranë si dhe trajtimin e fazës së katërt të përgatitjes së masave për trajtimin e risqeve të integritetit të institucionit dhe fazës së pestë të procesit të monitorimit të procesit të monitorimit të zbatimit të PI.

Një tjetër temë është edhe paraqitja e gjetjeve kryesore të raportit të sondazhit me skenarët hipotetikë mbi dilemat e etikës dhe integritetit në Policinë e Shtetit me qëllim që të kontribuojë, nëpërmjet evidencave, në debatin publik për forcimin e integritetit institucional të Policisë së Shtetit.

Vijon rubrika e ndarjes së përvojës së takimeve llogaridhënëse në bashkitë Lezhë dhe Pogradec, me qëllim forcimin dhe institucionalizimin e bashkëpunimit Polici-Bashki-Prokurori me grupet e interesit dhe komunitetin në nivel vendor. Gjatë takimit të dytë në Pogradec u shënua një qartësi më e madhe dhe vizion nga ana e shefit të komisariatit në adresimin e problematikave në komunikim të vazhdueshëm me qytetarët.

Mund të jepni kontributin tuaj me komente dhe shkrime për këtë buletin përmes komunikimit me botuesit tek info@idmalbania.org.

DILEMAT E ETIKËS DHE INTEGRITETIT NË POLICINË E SHTETIT

(PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË SONDAZHIT ME SKENARË HIPOTETIKË)⁴

Forcimi i integriteti policor përbën një nga sfidat kryesore për Policinë e Shtetit në përmbushjen e misionit të saj për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Gjatë përmbushjes së këtyre përgjegjësi, punonjësit e policisë mund të përballen me situata që vënë në provë etikën dhe integritetin profesional dhe të organizatës. Prirja e tyre për t'i rezistuar tundimit për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre nënkupton integritetin policor.

Në këtë kuadër, IDM gjatë periudhës nëntor 2018-janar 2019 administroi një pyetësor që mbështetet në vlerësimin e 15 rasteve hipotetike i njohur ndryshe si 'Shkalla e Klockars-it' me 225 punonjës policie në disa njësi policore në Tiranë, Durrës, Shijak, Vorë Lushnjë, Shkodër dhe Kavajë. Kjo qasje është zbatuar për herë të tretë në Shqipëri nga IDM përkatësisht në vitet 2014, 2016 dhe 2019 dhe fokusohet në aspektet e kulturës organizative të institucionit se sa prirjeve individuale të punonjësve të policisë.


Skenarët e pyetësorit të këtij viti parashtrojnë shkelje të tilla si: dypunësimi, pranimi i favoreve gjatë shërbimit, marrja e ryshfetit, pranimi i favoreve jashtë shërbimit, vjedhje nga vendi i krimit, pranim favoreve, mosraportim të shkeljes së kryer nga një koleg, pranim dhurate, përdorim i tepruar i forcës, vjedhje e sendeve të gjetura në vendngjarje, fshehje e dhunës në familje, diskriminim për shkak të etnisë, keqpërdorimi i kompetencave, fshehje e shkeljes me urdhër të eprorit dhe shprehje publike e mendimit.

Në këtë kontekst, raporti i sondazhit me skenarët hipotetikë ka për qëllim të kontribuojë, nëpërmjet evidencave, në debatin publik për integritetin policor, të ndihmojë Policinë e Shtetit në përmirësimin e kuadrit antikorrupsion. Gjithashtu, gjetjet e këtij raporti mund të shërbejnë për të furnizuar me evidencë trajnimin dhe formimin e mëtejshëm të punonjësve të policisë.





DISA NGA GJETJET MË TË RËNDËSISHME TË KËTIJ RAPORTI VLERËSIMI:

- ▣ Shkeljet “puna e dytë” dhe “shpërblimi jashtë shërbimit” janë shkeljet e vlerësuara si më pak serioze si në qëndrimin individual ashtu edhe në perceptimin ndër kolegë. Këto shkelje kanë vlerësimin më të ulët për gatishmërinë në raportim si në qëndrimin individual ashtu dhe në gatishmërinë për të raportuar ndër kolegë.
- ▣ Shkeljet “vjedhja nga vendi i krimit” dhe “marrja e ryshfetit” kanë marrë

4 Raportin e plotë mund ta shkarkoni në faqen e internetit të IDM: <http://idmalbania.org/download/6369/>



vlerësimin më të lartë për seriozitetin e shkeljeve. Shkelja “marrja e rryshfetit” ka marrë vlerësimin më të lartë në qëndrimin personal përse i përket seriozitetit të shkeljes sesa në perceptimin ndër kolegë.

- ▣ Shkelja diskriminim për shkak të etnisë, është vlerësuar më serioze (vlerësim mesatar më të lartë) nga grupi i punonjësve më të rinj në polici (më pak se 5 vite përvojë).
 - ▣ Shkeljet “puna e dytë” dhe “shprehja publike e mendimit” raportohen me masa disiplinore më të lehta krahasuar me shkeljet e lehta. Masat disiplinore që raportohen janë “ asnjë “për shkeljen “ punë e dytë” dhe “vërejtje” për shkeljen “shprehja publikisht mendimit personal”. Puna e dytë nuk perceptohet si shkelje e rëndë, për shkak të mirëkuptimit që ekziston mes kolegëve për përmbushjen e nevojave financiare përmes dy punësimit.
 - ▣ Ndërsa për shkeljen “përdorim i tepruar i forcës” raportohet masa më e rëndë disiplinore “largim nga policia”. Ky vlerësim vjen për shkak të ndërgjegjësimit më të madh në radhët e punonjësve të policisë në lidhje me rëndësinë dhe pasojat e kësaj shkeljeje për integritetin e policisë.
 - ▣ Gatishmëria për raportimin e shkeljeve vazhdon të mbetet e ulët. Vlerat mesatare për qëndrimet individuale janë më të ulëta se ato mbi perceptimet për gatishmërinë e kolegëve. Përrjashtim nga ky trend bëjnë shkeljet e vlerësuar si më serioze që mesatarisht do të gjenin më shumë gatishmëri në raportimin individual sesa në raportin sesa ndër kolegë (p.sh. marrje rryshfeti, vjedhje nga vendi i krimit, përdorimi i tepruar i forcës apo keqpërdorimi i kompetencave).
 - ▣ Grupi i të rinjve në polici (më pak se 5 vjet përvojë) raporton qëndrim më të zbutur ndaj shkeljeve të parashtruara në skenarë si në dhënien e masave disiplinore më të lehta ashtu edhe në drejtim të gatishmërisë për të raportuar ndër kolegë. Ky grup raporton edhe për gatishmëri më të ulët sesa e përgjithshmeja në raportimin e shkeljeve të kolegëve. Këto qëndrime mund të vijnë si pasojë e mungesës së informacionit për llojet e shkeljeve dhe pasojat që ato kanë në integritetin policor.
 - ▣ Të njëjtin qëndrim për sa më sipër, raportojnë dhe gratë police. Gratë police janë më së shumti të orientuara të punojnë në administratë sesa në terren dhe për rrjedhojë kanë mungesë informimi në lidhje me llojet e shkeljeve.
 - ▣ Grupi i punonjësve të policisë me më shumë përvojë në polici (mbi 30 vjet) dhe grupi punonjësve të nivelit drejtues në polici (punonjës me gradën Komisar), për shkak të përvojës dhe përgjegjshmërisë më të madhe, raportojnë masa disiplinore të ashpra për gjitha shkeljet e raportuara në skenarë. Qëndrim të njëjtë këto grupe raportojnë edhe në nivelin e lartë të gatishmërisë për raportim të kolegëve për shkeljet e parashtruara në skenarë. Shkeljet më të raportuara për këto grupe janë “ vjedhje nga vendi i krimit” dhe “marrja e rryshfetit”.
 - ▣ Kultura e heshtjes në raportimin e shkeljeve është një kulturë e instaluar në organizatën e policisë. Megjithatë, ka tendencë të thyhet nga punonjësit më me përvojë në policinë e shtetit (mbi 30 vjet përvojë) të cilët raportojnë tendencë më të lartë për të raportuar shkeljet e parashtruara në skenarë sesa grupet e tjera.
- 
- 
- 
- 

TENDENCAT E VLERËSIMIT TË RASTEVE HIPOTETIKE PËR PERIUDHËN 2014-2018

Perceptimi i punonjësve të policisë të anketuar për seriozitetin e sjelljeve të parashtruara në skenarët hipotetikë, nuk paraqet ndryshime të mëdha nga periudha 2014-2018. Të dhënat reflektojnë një tendencë në rënie të seriozitetit të perceptuar mes punonjësve të policisë për sa i përket ndikimit të një sërë sjelljesh në cenimin e integritetit të tilla si marrja e rryshfetit, vjedhje në vendin e ngjarjes, vjedhje e sendeve të gjetura, shpërblimi gjatë dhe jashtë shërbimit. Këto sjellje raportohen të jenë më pak cenuese të integritetit në vitin 2018, sesa perceptoheshin në 2014.

Nga ana tjetër të dhënat e vitit 2018 tregojnë se për rastet e paraqitura si p.sh. “të pasurit e një pune të dytë”, “mbulimi i shkeljes së një kolegu”, “marrja e përqindjeve për rekomandim” apo “keqpërdorimi i kompetencave” konsiderohen si më serioze në cenimin e integritetit të punonjësit të policisë krahasuar me vitet 2014, 2016.



Perceptimi i punonjësve të policisë mbi seriozitetin e shkeljeve të perceptuara nga kolektivi, ngjasojnë në dinamikë me qëndrimin individual të punonjësve të policisë.


Vihet re një trend i qëndrueshëm pozitiv që shkeljet “marrja e shpërblimeve”, “pranimi i dhuratave” apo “marrja e rryshfetit” perceptohen po aq serioze dhe të rënda sa dhe në vitet e mëparshme. Këto shkelje ndër vite vazhdojnë të perceptohen si veprime që cenojnë më së shumti integritetin e policisë. Ndërsa shkelja “vjedhja nga vendi i krimit” raportohet më e dënueshme në 2018 krahasuar me vitet e mëparshme.

Një tjetër aspekt në përmirësim lidhur me fenomenin ‘kulturës së heshtjes’ është fakti se punonjësit të policisë të anketuar, në vija të përgjithshme shprehin një gatishmëri më të lartë për të raportuar sjellje jo korrekte dhe cenuese të integritetit të punonjësve në policinë e shtetit në vitin 2018, krahasuar me vitet 2014 dhe 2016. Kjo gatishmëri është më e lartë në raportim për shkelje e vlerësuar si më serioze për integritetin e policisë.

DISA NGA REKOMANDIMET E PROPOZUARA:

- ▣ Përmirësimi i kapaciteteve trajnuese dhe kurrikulave të trajnimit të ofruara nga Akademia e Policisë me rishikimin e moduleve të veçanta mbi etikën, integritetin dhe instrumenteve të forcimit të integritetit. Ofrimi i moduleve të trajnimit të vazhduar të punonjësve të policisë (për të gjitha nivelet/gradat) mbi aktet apo rregullat e reja që miratohen në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të integritetit në polici.
- ▣ Hartimi i një plani pune për trajnimin e vazhduar të punonjësve të rinj në polici (kryesisht me më pak se 5 vjet përvojë në polici) dhe gratë police mbi module për etikën dhe integritetin në polici.
- ▣ Rishikimi i politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore në PSH, me fokus, përfshirjen e grave police në detyra në nivele drejtuese, për t’u njohur më mirë me përgjegjësitë për shkelje të caktuara gjatë ushtrimit të detyrave.



- 
- ▣ Rishikimi i ligjit në fuqi për policinë e shtetit, në lidhje me ndalimin e dypunësimit për punonjësit e policisë, duke e kufizuar atë me përcaktimet e Kodit të Punës në RSH.
 - ▣ Rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 101/201721 në lidhje me kompensimin e orëve shtesë 22 për punonjësit e policisë në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Kompensimi me shtesë në pagë në rast të pamundësisë së kompensimit të orëve shtesë me pushim të jetë për të gjitha orët faktike të kryera jashtë orarit zyrtar nga punonjësi i policisë.
 - ▣ Hartimi dhe miratimi i një Plani Integriteti në nivel organizate policore, bazuar në një metodologji të vlerësimit të riskut të integritetit për PSH, si një nevojë e forcimit të sistemit të menaxhimit të integritetit në organizatë. Ky plan synon të krijojë një mënyrë sistematike për të identifikuar të gjitha proceset dhe praktikatat të cilat janë në kompleks të administruara nga organizata policore si dhe për të identifikuar rreziqet që cenojnë mbarëvajtjen e tyre.
 - ▣ ‘Kultura e heshtjes’ që është ende shumë e pranishme në PSH mund të luftohet me garantimin e anonimitetit dhe konfidencialitetit për raportimin e sjelljeve jo etike ose korruptive brenda radhëve të policisë, duke u mbështetur në parashikimet ligjore të ligjit për sinjalizuesit.

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE LLOGARIDHËNËSE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

TREKËNDËSHI POLICI-BASHKI-PROKURORI NË DIALOG
TË HAPUR ME GRUPET E INTERESIT DHE KOMUNITETIN

LEZHË: NEVOJITET ANALIZE PERIODIKE E SHKAQEVE
TË KRIMINALITETIT NDËRMJET AKTORËVE VENDORË
PËR MASA EFIKASE PËR PARANDALIMIN DHE ULJEN E
NIVELIT TË KRIMINALITETIT

.....



Modeli i takimeve llogaridhënese për parandalimin e krimit të trekëndëshit polici-bashki-prokurori është zhvilluar tashmë në 15 bashki në vend dhe kanë shërbyer për të nxitur një formë të hapur komunikimi të autoriteteve vendore me qytetarët dhe grupet e interesit mbi problematikat e rendit, sigurisë publike dhe zbatimit të ligjit.

Në këtë kontekst, takimi llogaridhënës i radhës u zhvillua në Lezhë, ku

përfaqësuesit e trekëndëshit shprehën mbështetje të plotë për institucionalizimin e këtij bashkëpunimi. Nga ana tjetër kjo formë e re komunikimi u mirëprit nga të pranishmit përfaqësues të komuniteteve vendore, kryetar fshatrash, lagjesh, përfaqësues të institucioneve të arsimit, organizata jo qeveritare e media si një model për të trajtuar problematikat dhe shqetësimet mbi rendin dhe sigurinë publike drejtpërdrejtë me institucionet përgjegjëse.

Kryetari i Bashkisë z. Pjerin Ndreu theksoi se rritja e bashkëpunimit me aktorët përkatës është gjithmonë në dobi për një shoqëri më të shëndetshme dhe të sigurt. Ai vuri në dukje shtysat e natyrës sociale dhe ekonomike të përfshirjes në kriminalitet. Për këtë është e rëndësishme edhe lufta kundër “të fortëve” nga ana e policisë vendore.

Në mënyrë që të jepej një panoramë më e plotë e gjendjes së kriminalitetit në Lezhë, përfaqësuesi i Prokurorisë së rrethit z. Milan Laskaj përmendi statistikën vjetore për nivelin e kriminalitetit dhe cilësoi veprën penale të vjedhjes me numrin më të lartë të procedimeve penale. Në pjesën më të madhe të rasteve, autorët e këtyre veprave, kryesisht vjedhjes së zakonshme, janë individë me probleme të theksuara ekonomike ose të papunë tek të cilët vjedhja është shndërruar në burim dhe stil i të jetuarit.

Sipas z. Laskaj konstatimi dhe analizimi i shkaqeve që kanë çuar në rritjen e kriminalitetit ndihmon në marrjen e masave për parandalimin dhe uljen e nivelit të kriminalitetit në disa lloje të caktuara të veprave penale. Në këtë kuadër, duhet të krijohen mundësitë e punësimit në sektorin privat apo publik si dhe të hartohen programeve dhe strategji të ndryshme me qëllim që tu vijë në ndihmë shtresave në nevojë. Një

rol të rëndësishëm kanë edhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse të cilat përmes programeve të tyre edukuese, sensibilizuese apo të punësimit do të kenë një impakt pozitiv dhe do ndikojnë në uljen e kriminalitetit.

“Mendoj se këto tryeza ndërinstitucionale duhet të jenë më të shpeshta, në kuadrin e një bashkëpunimi sa më të frytshëm, evidentimin e problematikave dhe diskutimin për gjetjen e mundësive në zgjidhjen e tyre” tha z.Laskaj.

Ndër të tjera Drejtori i Policisë Vendore Lezhë z. Ferdinand Mara u shpreh se “siguria publike është përgjegjësi kryesore jo vetëm e policisë, por e të gjithë instancave vendore, shoqërisë civile dhe çdo qytetari vetë personalisht, ku dhe parandalimi e luftimi i kriminalitetit kërkon mbështetjen e të gjithëve.

Gjithashtu z. Mara vuri theksin tek nevoja e dialogut që në krye të herës për problematikën e ndryshme në mënyrë që të parandalohet një pjesë e madhe të fenomeneve shqetësuese.

Një tjetër aspekt që u evidentua gjatë këtij takimi ishte edhe nevoja e përmirësimit të bashkëpunimit të policisë me qeverisjen vendore veçanërisht në zonat rurale.





Në këtë drejtim, zonat e policimit u vlerësuan si pikë takimi e policisë me pushtetin vendor dhe qytetarët.

Përfaqësuesit e policisë-bashkisë-prokurorisë u angazhuan që gjatë muajit mars 2020 do të zhvillojnë takimin e radhës për problematikën e parandalimit të krimit dhe sigurisë publike.

BASHKIA POGRADEC: DREJT ZHVILLIMIT PERIODIK TË TAKIMEVE LLOGARIDHËNËSE TË TREKËNDËSHIT POLICI-BASHKI-PROKURORI

Në vijim të takimit të parë të zhvilluar në Pogradec në nëntor 2018 mbi situatën e rendit dhe sigurisë publike, Shefi i Komisarariatit Pogradec z. Nikollaq Palla, në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë z. Ilir Xhakolli dhe drejtuesin e Prokurorisë Pogradec z. Sotir Kllapi zhvilluan takimin e dytë llogaridhënës për të diskutuar mbi realizimin e angazhimeve të marra nga institucionet vendore si dhe sfidat e mëtejshme në këtë drejtim.

Në këtë takim u bë e mundur që një

pjesë e pjesëmarrësve në takimin e parë si përfaqësues të këshillit bashkiak, përfaqësues të organizatave jo-qeveritare dhe shoqatave të biznesit të ishin të pranishëm për një rivlerësim të problematikes së trajtuar në takimin e parë, zbatimin e angazhimeve të marra dhe vendosjen e objektivave deri në takimin e ardhshëm pas 6 muajsh.

Në fjalën e tij z. Ilir Xhakolli kërkoi që të zhvillohen takime llogaridhënëse në çdo njësi administrative ndërmjet strukturave



të bashkisë së bashku me punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, është rasti i dytë pas bashkisë Shkodër, ku kryetari i bashkisë angazhohet për të investuar për kamera sigurie në pika të ndryshme të qytetit dhe ato do menaxhohen nga policia.

Një tjetër angazhim për 6 muajt e ardhëm nga kryetari i bashkisë ishte edhe gatishmëria për t’iu përgjigjur organizimit të zonave policore me ngritjen e këshillave komunitar sipas neneve 68-69 të ligjit për qeverisjen vendore.

Nga ana tjetër, Shefi i Komisarariatit Pogradec z. Nikollaq Palla bëri thirrje për një policim proaktiv me përfshirjen e të gjithë komunitetit, përfshirë këtu edhe partneritetin me shoqërinë civile dhe shkollat, si dhe u angazhua për një rindarje të zonave policore në bazë të zonave me popullsi me numër më të madh, kriminalitetit më të lartë dhe faktorëve të tjerë social-ekonomikë në bashkëpunim me bashkinë.

Sipas, shefit të komisarariatit, takimet llogaridhënese bëjnë të mundur njohjen e partnerëve me nevojat për ndërhyrje sipas fushës të tyre të kompetencës, ndërhyrje këto që mund të përmirësojnë situatën e





sigurisë në komunitet. Për problemet dhe çështjet e identifikuara duhet të merren përsipër detyrime konkrete për adresimin e tyre dhe përcaktimin e personave të kontaktit për ndjekjen e problematikës dhe shkëmbimin e informacionit në periudhën në vazhdim. **Gjithashtu, funksionalizimi i Këshillave Vendor të Sigurisë Publike duhet të jenë një prioritet si dhe përfshirja e shoqërisë civile në to.**

Në përfundim të fjalës së tij, z. Palla theksoi se nga njëri takim llogaridhënës tek tjetri duhet të shihet ndryshim, duhet përballur me sfidat e qytetarëve dhe të zbatojmë angazhimet e marra përsipër.

Ndërsa në fjalën e tij, drejtuesi i Prokurorisë z. Sotir Kllapi bëri thirrje që të bëhet maksimumi nga çdo institucion për nxitjen dhe funksionimin e mekanizmave parandalues si në bashki (mekanizmi i referimit) por edhe në institucione të tjera si shkolla, etj. Duke theksuar gjithashtu se edhe bashkëpunimi i mirë prokurori, polici, gjykata ndikon në këtë drejtim. Nga ana

tjetër, prokurori vuri në dukje se çështja e kultivimit të kanabisit duhet të jetë në fokus edhe të institucioneve të policisë dhe bashkisë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në angazhimin e prokurorisë ishte edhe shprehja e gatishmërisë për thellimin e dialogut me qytetarët dhe bashkëpunimit me aktorët e tjerë vendorë, përfshirë edhe shoqërinë civile.

POLICI

BASHKI

PROKURORI

INTEGRITET



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands